



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura III  
Komisioni për Integritet Evropian  
Mbledhja nr. 36  
Prishtinë, më 03. 06. 2009, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**I mbledhjes së Komisionit për Integritet Evropian**

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova dhe Branislav Grbić.

Munguan: Džezair Murati dhe Sabri Hamiti.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 22. 04. 2009, të 29. 04. 2009 dhe raportet për vizitat nëpër komunat e Kosovës.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për lizingun financiar me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për tregti me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
6. Shqyrtimi i Projektligjit për themelimin e departamentit të mjekësisë ligjore me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
7. Shqyrtimi i Projektligjit për partneritetet publiko-private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me

legjislacionin e BE-së.

8. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012,
9. Të ndryshme.

#### 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

#### 2. Miratimi i procesverbaleve të 22. 04. 2009 dhe 29. 04. 2009 dhe raportet për vizitat nëpër komunat e Kosovës

*Procesverbalet dhe raportet u miratuan pa vërejtje.*

#### 3. Shqyrtimi i Projektligjit për lizingun financiar me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

**Kryesuesja** - Ftoi deputeten Njomza Emini - referuese e këtij projektligji, ta paraqiste raportin lidhur me përputhshmërinë e Projektligjit me *Acquis communautaire*.

**Njomza Emini** - Tha se në mbështetje me Divizionin për Standardizim kemi shqyrtuar këtë projektligj me amendamentet e Komisionit Funkcional dhe konsideroi se mund të procedohet, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

#### ***Përfundim***

***Projektligji për lizingun financiar me amendamente të Komisionit Funkcional nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.***

#### 4. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

**Kryesuesja** paraqiti raportin për përputhshmërinë e Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, sipas të cilit çështja e punësimit të shtetasve të huaj nuk rregullohet me *Acquis communautaire* dhe me politikat e BE. Konstatoi se Komisioni nxori këtë

#### ***Përfundim***

***Çështja e punësimit të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës është lënë në kompetencë të secilit shtet, sepse kjo çështje nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së.***

#### 5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për tregti me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

**Kryesuesja** – E ftoi deputetin Naser Rugova - referues i këtij projektligji, ta paraqiste raportin për përputhshmërinë e Projektligjit me *Acquis communautaire*.

**Naser Rugova** - Tha se në mbështetje me Divizioni për Standardizim kemi shqyrtuar këtë projektligj me amendamentet e Komisionit Funkcional dhe konsideroi se mund të procedohet, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*. Sa i përket projektligjit tha se duhet të kërkohet nga sponsoruesi dhe nga Komisioni Funkcional ta paraqesin memorandum shpjegues për amendamentet dhe proceduarat, sepse ky projektligj është për plotësimin dhe për ndryshimin e Ligjit.

**Hydajet Hyseni** - Tha se vërejtja e deputetit Rugova është me vend, mirëpo kjo çështje nuk është në kompetencë e Komisionit tonë, sepse me të duhet të merret Komisioni Funkcional ose Komisioni për Legjislacion. Shtoi se jemi të thirrur të japim vërejtje vetëm sa i përket përputhshmërisë së legjislacionit tonë me atë të BE-së.

**Nait Hasani** - Kompetencë e Komisionit tonë është vetëm çështja e përputhshmërisë së legjislacionit tonë me atë të BE-së.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

#### *Përfundim*

*Projektligji për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për tregti me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.*

#### **6. Shqyrtimi i Projektligjit për themelimin e departamentit të mjekësisë ligjore me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesja** - Ftoi deputetin Bujar Bukoshi - referues i këtij projektligji, ta paraqiste raportin për përputhshmërinë e Projektligjit me *Acquis communautaire*.

**Bujar Bukoshi** - Tha se themelimi i departamentit të mjekësisë ligjore është fushë e cila është lënë që secili shtet ta rregullojë veçmas, sepse kjo fushë nuk është e rregulluar me *Acquis communautaire*. Shfaqti mosbesim se ky departament nuk do të funksiononte në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, sepse sipas tij, ky departament do të duhej të ishte në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

**Kryesuesja** - Tha se Ministria e Shëndetësisë nuk e ka kundërshtuar vendimin që ky departament të funksionojë, kështu siç është paraparë, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

***Përfundim***

***Themelimi i departamentit të mjekësisë ligjore është lënë në kompetencë të secilit shtet, sepse kjo çështje nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së.***

**7. Shqyrtimi i Projektligjit për partneritetet publiko-private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesja** - Ftoi deputetin Fatmir Rexhepin - referues i këtij projektligji, të paraqiste raportin për përputhshmërinë e Projektligjit me *Acquis communautaire*.

**Fatmir Rexhepi** - Tha se kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe amendamentet e Komisionit Funkcional dhe konsiderojmë se mund të procedohet tutje, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

***Përfundim***

***Projektligjit për partneritetet publiko-private dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.***

**8. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012**

**Kryesuesja** - Tha se është kërkuar nga Komisionit për Integritet Evropian t'i paraqesë rekomandimet dhe një raport për seancën plenare për Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2010-2012.

**Fatmir Rexhepi** - Pyeti cila është detyra e Komisionit për këtë kornizë. Shtoi se nuk jemi seriozë për temën për të cilën do të diskutojmë. Kjo kornizë duhet të shqyrtohet me përkushtim dhe me vëmendje, sepse në të parashihet zhvillimi afatgjatë i një vendi. Unë nuk e përkrah këtë dokument si të tillë. Ky dokument ka të bëjë me investime, kurse nuk kemi asnjë cent për investime. Në këtë kornizë është paraparë rregullimi i shumë rrugëve në pjesë të ndryshme të Kosovës, ndërsa në rrugën Prishtinë-Gjilan nuk është paraparë asnjë arterie. Kjo politikë duhet të korrigjohet. Nëse kjo kornizë miratohet kështu siç është, unë, si deputet, do ta bëjë problemin më të madh politik.

**Kryesuesja** - Tha se në procesin e integritet evropian janë tri pika kryesore: zhvillimi ekonomik, legjislacioni dhe *Acquis communautaire*. Në këtë dokument janë paraqitur këto çështje, prandaj duhet të shqyrtohet edhe nga Komisioni ynë.

**Hydajet Hyseni** - Tha se këtu duhet të përqendrohemi për ta parë si është raporti me *Acquis communautaire* dhe me procesin e integritimeve evropiane. Na lë përshtypje sa është marrë parasysh procesi i integritimeve evropiane dhe cilat janë hapat që i ka bërë Kosova për prioritetet e saj. Shtoi se është shumë e rëndësishme të përmendet reforma në drejtësi. Përpjekjet tona në këtë lëmë nuk janë përfshirë në Kornizë. Për fushëveprimtarinë tonë kemi çka të diskutojmë. Propozoi që ky dokument të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme, në të cilën deputetët do të bëjnë propozime konkrete lidhur me këtë kornizë.

**Naser Rugova** - Tha se Korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument shumë i rëndësishëm dhe serioz për shtetet dhe për qeveritë e çdo vendi. Kjo është e rëndësishme sidomos për fazën në të cilën është Kosova. Shtoi se pas anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar ky dokument paraqet aktin më të rëndësishëm. Vuri në pah se Korniza është hartuar në mënyrë joprofesionale, me gjuhë juridike, ekonomike e politike shumë të paqartë. Përpos që është konfuze ka dhe me zbrazëti serioze dhe të rëndësishme në përmbajtje. Komisionit për Integritime është shumë i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me orientimin e politikave, për të cilat duhet të mbështetemi në kriteret e Kopenhagës, siç janë: objektivat politikë, sundimi i rendit dhe i ligjit, reforma në administratën publike etj., Shtoi se nga 110 sfida, që dalin nga Raporti i fundit të progresit të Komisionit Evropian, kjo kornizë afatmesme e shpenzimeve përgjigjet vetëm në 45-50 sosh dhe atë në formë jo të prerë, jo të vendosur, sepse mungon vullneti politik. Ka mospërputhje dhe mangësi të mëdha në orientime për zhvillim kombëtar, sepse mazhoranca po e rajonalizon vendin. Komisioni për Integritime duhet ta shfaqë mendimin duke u mbështetur në prioritetet. Për të gjitha këto që u thanë duhet të hartohet një raport serioz që mbështet mirë në kriteret e Kopenhagës dhe në objektivat e Kosovës, sepse jemi i vetmi vend që nuk e kemi nënshkruar Marrëveshjen e stabilizim asociimit.

*Pas diskutimeve të deputetëve kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

### ***Përfundim***

***Korniza afatmesme e shpenzimeve për periudhën 2010-2012 të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme.***

#### **9. Të ndryshme.**

##### **a) Takimi me delegacionin e Parlamentit të Kroacisë**

**Kryesuesja** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se më 8 qershor 2009 është paraparë të vijë një delegacion i Parlamentit të Kroacisë, me të cilin do të takohet edhe Komisioni për Integritime Evropiane.

##### **b) Raporti i takimit për Letrën e bardhë**

**Naser Rugova** - Tha se është mbajtur punëtorja e dytë me përfaqësues të komisioneve të tjera funksionale dhe me ekspertë të UNDP-së. Njoftoi se pas vërejtjeve që janë bërë në punëtorinë e parë dokumenti kishte ndryshuar në formë dhe në përmbajtje dhe se ndryshimi ishte meritë e vërejtjeve të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Shtoi se punëtorja e dytë bëri edhe vërejtje të tjera, përdori terma të rinj, përfshiu në shoqëri një numër të caktuar të fokusgrupeve të përjashtuara dhe hoqi disa terma të panevojshëm. Beson se ekspertët që do të

punojnë në Letrën e bardhë, pas inkorporimit të vërejtjeve dhe të sugjerimeve, do të nxjerrin një dokument të kompletuar. Shtoi se Letra e bardhë është dokument që nuk detyron dhe nuk ka implikime buxhetore. Letra e bardhë pas deklaratës së mijëvjeçarit është zotim i vullnetit të mirë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe lidhet drejtpërsëdrejti me agjendën evropiane për Kosovën. Vuri në pah se Komisioni duhet ta japë mendimin përfundimtar. Këtë dokument është ngarkuar ta shqyrtojë edhe Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale ta paraqesë mendimin e vet. Pas kësaj ky dokument do të procedohet në Kryesinë e Kuvendit dhe do të dërgohet në seancë për miratim.

### **c) Konkluzionet nga takimi i PVPE-së**

**Kryesuesja** paraqiti konkluzionet e takimit të mbledhjes së 25. 05. 2009, që u mbajt me kryetarët e komisioneve parlamentare.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i miratoi konkluzionet e mbledhjes së 25. 05. 2009.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E hartoi:  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

---

Zylfije Hundozi